



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

Numri i lëndës: 2020:183887  
Datë: 26.01.2026  
Numri i dokumentit: 08366265

K.DH.SH.II.nr.681/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Fisnik NULI, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Klajger Konstruksion” Sh.P.K., dega në Kosovë, me numër unik identifikues 811347386 dhe seli në Pejë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Taulant Hajdari, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.523/22 te datës 05.02.2024, me datën 26.01.2026, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.523/22 te datës 05.02.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.523/22 te datës 05.02.2024, ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa urdhrin përmbarimor P.nr.290/2020 te datës 07.12.2020, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim Metaj e ka lënë ne fuqi dhe e ka detyruar debitorin qe ne emër te shpenzimeve për përfaqësim ne seancë dëgjimore kreditorit ti paguaj shumen prej 270 euro, ne afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkalles së dytë këtë ankesë ta aprovoj në tërësi si të bazuar, aktvendimin e atakuar ta shfuqizoj ashtu që të hiqen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Përgjigje në ankesën e debitorit ka ushtruar kreditori duke cekur se pretendimet e debitorit në ankesë janë të pabazuara, propozon që gjykata e shkalles së dytë ankesën ta refuzoj në tërësi, aktvendimin e atakuar ta vërtetoj dhe ta obligoj debitorin në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Klajger Konstruksion” Sh.P.K., dega në Kosovë, me numër unik identifikues 811347386 dhe seli në Pejë, më datën 07.12.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr.06 të datës 30.03.2020 e cila rrjedh nga kontrata Publike Kornizë Ref.nr.203/15/19 me numër prokurimi 203-19-4449-2-1-1 dhe numër të brendshëm 203-019-014-211. Përmbaruesi Privat Kushtrim Metaj, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.290/20 të datës 07.12.2020, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që në emër të borxhit nga fatura, kreditorit t’i paguaj shumën prej 101,052.210 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e afatit për pagesë të faturës deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet në procedurës përmbarimore.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 11.12.2020, me arsyetimin se me kreditorin kanë pasur kontratë publike kornizë, në të cilën kontratë janë përcaktuar të drejtat dhe detyrat e palëve kontraktuese, përkatësisht është përcaktuar edhe vlera e projektit në lartësi prej 700,000.00 euro, si vlerë fikse e cila nuk do të nënshtrohet ndryshimeve. Ndërsa, ka

shtuar se kreditori ka bërë tejkalime të shpenzimeve të kryerjes së shërbimeve të pa porositura nga debitorit dhe në asnjë rast nuk e ka informuar debitorin. Me tej, ka theksuar se nuk ka pasur pëlqim, miratim ose ndonjë vendim për miratim, ashtu që shërbimet janë kryer jashtë vlerës së lejuar të kontratës e që bie ndesh me legjislacionin në fuqi të prokurimit publik. Në fund, ka theksuar se kreditori përkundër vështirësive buxhetore, detyrimet e veta i ka kryer sipas kontratës duke ia kompensuar kreditorit vlerën e përgjithshme prej 771,221.44 euro, ashtu që për shumën e kompensuar përtej kontratës, përkatësisht për vlerën prej 71,221.44 euro, do të kërkohet nga kreditori që të kthehet, ose në të kundërtën do të iniciohet procedurë gjyqësore për kthimin e kësaj pjese monetare të paguar përtej vlerës së përcaktuar në kontratë. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Përgjigje ndaj prapësimin të debitorit ka ushtruar kreditori me datën 15.12.2020, me arsyetimin se kreditori disponon me shkresë zyrtare dhe kërkesë për aprovimin e planit dinamik për ekzekutimin e projektit për periudhën Janar/Dhjetor 2020, pranë Komisionit të Menaxherëve të Kontratës si dhe shkresën “Kthim i përgjegjëse” së datës 30.01.2020 nga Komisioni i Menaxherëve në kuadër të debitorit për aprovimin e planit dinamik të propozuar për periudhën Janar/Dhjetor 2020. Me tej, kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se fatura objekt përmbartimi është lëshuar sipas kontratës dhe sipas miratimit për vazhdimin e projektit dhe mënyrës së situacionit me çmimin njësi nga KRPP dhe pas aprovimit të Planit dinamik për ekzekutimin e projektit për periudhën Janar/Dhjetor 2020 të miratuar nga Menaxheri i Kontratës. Në fund, ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk i përmbush elementet e përcaktuar në LPP-së, ndërsa fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri është lëshuar në zbatim të kontratës publike kornizë me nr. Ref. 203/15/19, e datës 19.09.2019, ka fuqinë e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.523/22 të datës 05.02.2024, me të cilin e ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetimin të aktvendimit gjykata bazuar në shkresat e lëndës gjen se prapësimi i debitorit është i pabazuar. I referohet nenit 29 par.1 nenpar.1.3 dhe par.3 i cili

parasheh qe *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”* dhe nenit 37 të LPP-së i cili parasheh qe *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Vlerëson se fatura nr.06 te datës 30.03.2020, derivon nga Kontrata publike kornizë me numër të ref. 203/15/19, “Për programin kombëtar për inventarizimin e tokave bujqësore të Republikës së Kosovës, për komuna Pejë, Deçan, Istog dhe Junik, Lot 1”, e lidhur mes palëve, e datës 19.09.2019, mbi bazën e te cilës është lejuar përmbardimi, është dokument i përshtatshëm për ekzekutim sepse e njëjta ka tiparet e një dokumenti te besueshëm pasi përmban te dhëna për palët, përkatësisht kreditorin dhe debitorin, janë të përshkruara shërbimet si objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit dhe koha e përmbushjes, është e pranuar nga debitori ne mënyrë te rregullt gjë qe e vërteton nënshkrimi i debitorit ne faturë, gjë qe vërtetohet edhe nga provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës, përkatësisht nga shkresa e datës 04.06.2020, e zëvendës shefes së Divizionit për Buxhet dhe Financa në kuadër të debitorit, drejtuar Drejtorit të Thesarit, përmes së cilës ka kërkuar alokimin e mjeteve financiare me qëllim të përmbushjes së faturës së pranuar nga kreditori në vlerë prej euro 101,052.21, nga rezulton se kjo faturë është e përshtatshme për ekzekutim, e njëjta po ashtu propozimit për përmbardim i është bashkëngjitur ne origjinal. Gjykata, ka vlerësuar pretendimet e debitorit se kreditori ka kryer shërbime pa pëlqim, miratim apo vendim të debitorit, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara ngase nga shkresat e lëndës, përkatësisht shkresa mbi aprovimin e planit dinamik e datës 30.01.2020 e lëshuar nga Komisioni – Menaxherët e kontratës në kuadër të debitorit, rezulton se kryerja e punëve është bërë me pëlqimin e këtij komisioni, ndërsa përmes shkrësës së datës 03.04.2020, nga i njëjti komision është konfirmuar se kreditori ka realizuar aktivitetet sipas specifikimeve teknike të përshkruara në dosje të tenderit në vlerë prej 101,052.210 euro. Po ashtu pretendimet e debitorit se shërbimet janë kryer jashtë vlerës se lejuar me kontratën bazë dhe së debitori ka pranuar mjete me tepër se çmimi i parashikuar i kontratës gjë qe bie ndesh me Ligjin e Prokurimit Publik por gjykata për shkak te parimit te rigorozitetit juridik formal ne këtë procedurë nuk është lëshuar ne këtë pretendim pasi qe gjykata ne këtë faze te procedurës vlerëson vetëm përshtatshmërinë e dokumentit mbi bazën e te cilit është lejuar përmbardimi dhe jo te dhe rrethanave tjera, megjithëqë qe gjykata vlerëson te drejtën

e palës debitore që përkitazi këtyre pretendimeve të inicioj procedure të rregullt civile. Në lidhje me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur konform nenit 463 dhe 453 të LPK lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP, dhe meqë pretendimet e paraqitura në prapësim nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbartimor sipas nenit 71 të LPP, konform nenit 73 të LPP vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës nr.06 të datës 30.03.2020, e lëshuar nga kreditori e cila propozimit për përmbartim i është bashkangjitur në origjinal dhe në pajtim me nenin 37 të LPP i cili parasheh që *“kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Kjo faturë është e nënshkruar nga debitori, element ky bazë që shpreh vërtetësinë e një dokumenti se i njëjti është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori pasi që dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbartimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbartimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Fatura plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 29 të LPP-së dhe si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit, sepse i përmban elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të këtij neni, i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Fakti se nga shkresa e datës 04.06.2020, e zëvendës shëfës së Divizionit për Buxhet dhe Financa, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, ku kërkon alokimin e mjeteve financiare me qëllim të përmbushjes së faturës së pranuar nga kreditori, edhe për këtë gjykatë del se debitori ka pranuar faturën dhe detyrimin nga fatura në shumën prej 101,052.21 euro.

Prandaj, bazuar në këto arsye, Gjykata e shkalles së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkalles së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në

shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi pretendimet ankimore te debitorit se operatori ekonomik tani kreditor kishte bere tejkallim te shpenzimeve me rastin e kryerjes se shërbimeve te pa porositura nga tani debitori dhe nuk e ka informuar debitorin, se pa pëlqim dhe pa miratim ka kryer shërbime jashtë vlerës se kontratës dhe se debitori përkundër vështirësive financiare ka përmbush te gjitha detyrimet e saj ndaj kreditori ne shumën e përgjithshme prej 771,221.44 euro, më pastaj se gjykata nuk e mori parasysh faktin se përmbarimi është lejuar ne shumen e tejkeluar te vlerës se kontratës bazë e qe ishte 700,000.00 euro dhe atë pa miratim paraprak nga debitori ashtu siç përcaktohej me kontratën e datës 23.09.2019 ne nenin 1 par.1.4 dhe nenin 3 te kësaj kontratë, mirëpo bazuar ne parimin e rigorozitetit juridik formal, gjykata ne këtë procedurë kufizohet vetëm ne vlerësimin e përshtatshmërisë se dokumentit mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarimi dhe jo edhe rrethanave tjera për çka lidhur me këto pretendime sugjeron palën debitore ne procedura tjera siç, ashtu qe këto pretendime i refuzoi ndërsa aktvendimin e shkallës se parë ta vërtetoi.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkallës se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhomat e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.681/24, me datë 26.01.2026

Gj y q t a r i,  
Fisnik NULI